



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0594-A0001

Në ankesën e

Paditësi/ankuesi

T D, Pejë.

kundër

E paditura

NSH, "UTVA", të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-0653 të datës 21 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 04 prill 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-13-0653 i datës 21 shtator 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 30 prill 2013, paditësi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr.PEJ091-0141 të datës 22 mars 2013, të Autoritetit të Likuidimit të

Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej shkurt AL), më të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, në shumë prej 1,000.00 euro nga NSH"UTVA" (në Likuidim), si e pa bazë, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH-së. Padiësi në ankesën e paraqitur pranë DHPGJS-së konsideron se është bërë shkelje e ligjit material, bazuar në faktin se ai ka mbi 30 vjet përvojë pune kurse, paga e tij ishte 200,00 euro për muaj, andaj (sipas Ligjit të ri të Punës nr.03/L-212) i takojnë 7 paga mujore, respektivisht 1.400,00 euro. Përveç borxhit kryesor , në bazë të dispozitave të nenit 37 par.3 të ligjit për AKP, pala padiëse kërkon edhe kompensimin e kamatës. Në fund padiësi ka kërkuar nga DHPGJS që të aprovohet ankesa si e bazuar në dispozita pozitive, të anulohet vendimi i AKP-së si i kundërligjshëm. Padiësi së bashku me ankesë ka bashkangjitur kopjen e vendimit të AL-së me numër PEJ091-0141 i datës 22 mars 2013, kopjen e njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës e datës 24 gusht 2005, kopjen e vërtetimit të datës 06 mars 2012, kopjen e listës së punëtorëve, kopjen e formularit për kërkesë pranë AKP-së.

Me 10 tetor 2016, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit që ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se padiësi ka qenë punëtor i NSH-së për disa vite, pas vitit 1999 forcat e NATO-s janë vendosur në ambientet e NSH-së. Rrjedhimisht NSH-ja nuk ka qenë funksionale pas vitit 1999 dhe parashtruesi nuk ka punuar në të. Më tutje AKP-ja thekson se ankesa është e pa pranueshme në kuptim të nenit 28.2.4 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033 për AKP-në, i cili parashihet se ankesa duhet dorëzuar brenda afateve të përcaktuara në ligj. Neni 70.2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L033 si dhe neni 37.7 i Shtojcës së Ligjit qartazi parashohin një afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit për dorëzimin e ankesës në DHPGJS. Në bazë të fletë kthesës postare, padiësi e ka pranuar vendimin me 28 mars 2013 ndërsa Ankesa është dorëzuar në Gjykatë më 30 prill 2013. Afati i fundit për dorëzim të ankesës ishte më 27 prill 2013, prandaj kjo ankesë është e pa pranueshme. Tutje në mbrojtjen e saj theksohet se ankesa

është e pa bazuar duke u bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L034 nga AL-ja, siç është konfirmuar edhe nga menaxhmenti i NSH-së të gjithë punëtorët e NSH-së rreshtën së punuari nga 1999 në vazhdim për shkak se ambientet e NSH-së nuk është një veprim i AKP-së. Prandaj duke qenë se marrëdhënia e punës nuk iu është ndërpre si rezolutat i një veprimi të AKP-së, por shumë vite më parë si rezultat i një veprimi të palëve të treta, parashtruesit nuk i takon e drejta për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme. Në fund AKP-ja kërkon nga Dhoma e Posaçme që të bëhet refuzimi i ankesës si i pa pranueshëm apo i pa bazuar. AKP-ja së bashku me mbrojtjen i ka bashkangjitur kopjen e flete kthesës e cila dëshmon datën e marrjes së vendimit me postë datë 28 mars 2013.

Më 07 nëntor 2016, paditësi u përgjigj në mbrojtjen e AKP-së, në të cilën thekson se e kundërshton mbrojtjen e agjencisë dhe duke u bazuar në aftin se pala paditëse ka mbi 30 vjet stazh pune, palës paditëse i takojnë 5 paga mujore, respektivisht 1,000.00 euro, përpos borxhit kryesor. Ankuesi kërkon që të aprovohet padia e paditësit dhe të refuzohet mbrojtja e parashtruar nga AKP-ja.

Më 25 nëntor 2016, e paditura dorëzon kundërpërgjigjen e saj në të cilën thekson se parashtruesi në përgjigjen e tij nuk ka ofruar ndonjë argument shtesë rrjedhimisht qëndrimi i të paditurës është i njëjtë si në mbrojtjen e parashtruar më lartë.

Më 21 shtator 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së me Aktvendimin C-IV.-13-0653, ankesën e ankuesit e ka hedhet poshtë si të pa pranueshme. Në arsyetim të vendimit thuhet se duke u bazuar në nenin 70.2 të Shtojcës së ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se "Çdo kreditor i ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në agjenci dhe i cili cenohet nga një vendim i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit...".

Po ashtu në bazë të nenit 37.7 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili parasheh:" Kreditori i prekur ka të drejte të kërkojë

nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kërkitimi i tillë në kohë nga na e kreditorit do ta pamundësojë që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kërkitimi i tillë në kohë nga na e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtim të mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit”.

Shkalla e I-rë duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka konstatuar se paditësi nuk i përmbushë kriteret e pranueshmerisë të përcaktuara në nenet 28.2.2.6 dhe 70.2 të Shtojcës së ligjit për Dhomën e Posaçme sipas nenit 37.7 të Shtojcës për AKP-në. Shkalla e I-rë në arsyetim ka theksuar se paditësi nuk e ka dorëzuar ankesën në gjykatë brenda afatit prej 30 ditëve nga data kur ai ka pranuar vendimin e ankimuar. Sipas fletës kthesës të dorëzuar nga AKP-ja, konstatohet se vendimi i ishte dorëzuar ankuesit më 28 mars 2013, që do të thotë se afati i fundit për ankesë kundër këtij vendimi në Dhomën e Posaçme ishte data 27 prill 2013. Ankuesi dorëzoi ankesën e tij kundër vendimit në fjalë më 30 prill 2013, që do të thotë pas afatit.

Me 24 tetor 2022, paditësi/ankuesi dorëzoi një ankesë në Kolegjin e Apelit DHPGJS-ë një ankesë kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-13-0653, të datës 21 shtator 2022, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i atakuar dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Paditësi në ankesën e parashtruar thekson se duke pas parasysh se Ligji për DHPGJS ka hyrë në fuqi më 22 shtator 2011 dhe është ndryshuar dhe plotësuar më 07 shtator 2012, ndërsa ai ka iniciuar kontestin gjyqësor më 30 prill 2013, rrjedhimisht rezulton se Ligji në fjalë sikurse është ndryshuar dhe plotësuar është ligj i aplikueshëm dhe që zbatohet në rastin e gjykimit të këtij kontesti. Tutje ka theksuar se gjykata duhet pasur parasysh që në rastin konkret kemi të bëjmë me një ankesë, të paraqitur kundër një Vendimi të së paditurës, më konkretisht ankesë kundër Vendimit të së paditurës me numër PEJ091-0141, të datës 22 mars 2013. Po ashtu paditësi ka theksuar që se afati ligjor për paraqitjen e ankesave përcaktohet në Ligjin për DHPGJS, Nenin 6, paragrafi 2, i cili parasheh që “Çdo person që kundërshton një vendim a veprim të Agjencisë, që është ndërmarrë në datën apo pas datës së hyrjes në fuqi të këtij

ligji, duhet të parashtrorë kërkesën apo ankesën në fjalë tek Dhoma e Posaçme jo më vonë se njëqind e njëzet ditë (120) pas datës në të cilën vendimi apo veprimi i është dorëzuar personit në fjalë, ose, nëse një dorëzim i tillë nuk kërkohet me ligj, apo nëse dorëzimi i tillë nuk ka qenë i mundshëm apo i arritshëm përkundër përpjekjeve në mirëbesim nga Agjencia, i shpallur në pajtim me politikat operative të Agjencisë dhe dispozitat e nenit 10.3 të ligjit mbi AKP-në. Dhoma e Posaçme nuk do ta pranojë, si dhe do të refuzojë, secilin kundërshtim që parashtrorë pas kalimit të periudhës së përcaktuar prej njëqind e njëzet ditësh (120).”

Paditësi në ankesën e parashtruar po ashtu ka theksuar se Vendimin e të paditurës ai e ka pranuar më 28 mars 2013, ndërkaq ankesën kundër Vendimit e ka paraqitur më 30 prill 2013, fakte këto që argumentuar andaj ankesa është paraqitur brenda afatit prej 120 ditëve, të përcaktuar në dispozitën e lartcekur të Ligjit për DHPGJS. Paditësi e kundërshton arsyetimin e konstatuar nga Shkalla e I-rë, pasi që thirret, në Nenin 37, paragrafi 7, të Ligjit nr.04/L034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili përcakton që “Kreditori i prekur ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve. Sipas tij dispozita në fjalë e qartëson se ndërlidhet me kërkesat që kanë të bëjnë me një njoftim të AKP-së dhe konsideron se rastin konkret dispozita në fjalë nuk mund të zbatohet.

Paditësi në ankesën e parashtruar pranë Kolegjit të Apelit për shkak të arsyeve të lartcekura konsideron se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur ka hedhur poshtë si të palejuar Ankesën me pretendimin se afati Ligjor për paraqitje të ankesave është tridhjetë(30) ditë.

Më 20 dhjetor 2023, APK-ja ka parashtruar përgjigjen në ankesën, në të cilën ka propozuar që ankesa e ankuesit të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar. Në këtë parashtrësë AKP-ja pohon se qëndrimin e saj lidhur me argumentet e Ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmërisht e sqaruar në Mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktvendimin me nr.C-IV.-13-0653 nga DHPGJS, pranë shkallës së I-re. Përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës,

për këtë arsye pala kundërshtare i parashtron Kolegjit të ankesave që t'i referohet Mbrojtjes së Aktvendimit përkatës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjorë, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi kishte dorëzuar kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, më të cilin ka kërkuar që të kompensohet për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, në shumë prej 1,000.00 euro nga NSH"UTVA" (në Likuidim), por që AL kërkesën e tij e kishte refuzuar si të pa bazuar, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH-së në kohën e privatizimit.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së kishte marrë Aktvendimin C-IV.-13-0653, me të cilën ankesa e ankuesit hedhet poshtë si e pa pranueshme. Në arsyetim të vendimit thuhet se duke u bazuar në nenin 70.2 të Shtojcës së ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se 'Çdo kreditor i ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në agjenci dhe i cili cenohet nga një vendim i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit...'. Po ashtu në bazë të nenit 37.7 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili parasheh:" Kreditori i prekur ka të drejtë

të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kërkitimi i tillë në kohë nga na e kreditorit do ta pamundësojë që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kërkitimi i tillë në kohë nga na e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtim të mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit”.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë e cila ka konstatuar se paditësi nuk i përmbushë kriteret e pranushemëris të përcaktuara në nenet 28.2.2.6 dhe 70.2 të Shtojcës së ligjit për Dhomën e Posaçme. Sipas nenit 37.7 të Shtojcës për AKP-në. Shkalla e I-rë me të drejtë ka theksuar se paditësi nuk e ka dorëzuar ankesën në gjykatë brenda afatit prej 30 ditëve nga data kur ai ka pranuar vendimin e ankimuar. Sipas fletës kthesës të dorëzuar nga AKP-ja, konstatohet se vendimi i ishte dorëzuar paditësit më 28 mars 2013, që do të thotë se afati i fundit për ankesë kundër këtij vendimi në Dhomën e Posaçme ishte data 27 prill 2013. Ankuesi dorëzoi ankesën e tij kundër vendimit në fjalë më 30 prill 2013, që do të thotë pas afatit.

Kolegji i apelit vëren se paditësi/ankuesi i cili në ankesën e parashtruar e pohon faktin se Vendimin e të paditurës, e ka pranuar më 28 mars 2013, ndërkaq ankesën kundër Vendimit e ka paraqitur më 30 prill 2013.

Kolegji i Apelit nuk i mbështet pretendimet e paditësit/ankuesit që afati ligjor për paraqitjen e ankesave përcaktohet në Ligjin për DHPGJS, Nenin 6, paragrafi 2, i cili parasheh që “Çdo person që kundërshton një vendim a veprim të Agjencisë, që është ndërmarrë në datën apo pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të parashtrorjë kërkesën apo ankesën në fjalë tek Dhoma e Posaçme jo më vonë se njëqind e njëzet ditë (120) pas datës në të cilën vendimi apo veprimi i është dorëzuar personit në fjalë. Ky afat ligjor në të cilën thirret paditësi ka të bëjë me çështje të tjetra që lidhen me privatizimin e asteve dhe futjen e NSH-ve në menaxhimin e AKP-së si dhe veprimeve tjera të AKP-së, por asesi me vendimet e Autoritetit të Likuidimit, siç është rasti i paditësit me të cilën vendosen kërkesat kreditore.

Kolegji i Apelit vëren se edhe Shtojca e Ligjit për DHPGJS në nenin 70.2 të, por edhe nenin 74.2 i Ligjit aktual për DHPGJS, përcaktojnë se *“Çdo kreditor i ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendim i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit...”*. Po ashtu në bazë të nenit 37.7 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili parasheh:

“Kreditori i prekur ka të drejte të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kërkitimi i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtimin e mëtejshëm të vendimit të Autoritetit të Likuidimit”. Andaj duke u bazuar në arsyet e lartcekura Kolegji i Apelit ka konstatuar se Aktvendimi i shkallës së I-rë është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj nga se u tha më lartë, rezultati i dhënë me Akvendimin e ankimuar, nuk ka mundësi të ndryshohet, andaj ankesa e paditësit/ankuesit refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksa gjyqësore

Në bazë të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr.01/2017, të datës 22 mars 2017, paditësi nuk ngarkohet me taksë gjyqësore, meqë vlera e kontestit nuk kalon shumen prej 1000 euro.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 04 prill 2024

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
